



Datë: 09.02.2026

Numër Protokolli: 762/2026

A.nr.1665/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1665/2025, të datës 05.09.2025, të parashtruar nga ankuesja M.B, kundër organit të punësimit/Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike “*shkelje e të drejtës në pagë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 09.02.2026, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon Procedimi Administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.1665/2025, të datës 05.09.2025 e parashtruar nga ankuesja M.B.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, M.B (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), me datë 01.09.2025, përmes postës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar më datë 05.09.2025 dhe e regjistruar nën shenjën A.nr.1665/2025, kundër heshtjes administrative të organit të punësimit/Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, në kërkesën e saj të datës 20.03.2025 edhe përkundër Vendimit A.nr.943/2025 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Kolegji i Këshillit) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës, ndërsa, jo e fundit ka dërguar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesa me numër protokolli 5978/2025 të datës 05.09.2025, e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të

Kosovës; Zarfin e datës 01.09.2025; Ankesa me numër protokolli 3401/2025 të datës 22.05.2025, e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën Nr.14-117/01-40258/25 e datës 20.03.2025; Akt Emërimit me Nr. 01-112-314 të datës 16.11.2024; Kopjen e ID-së së ankueses; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 30.05.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 03.06.2025; Akt Emërimit 01nr.112-314 të datës 01.02.2017; Kërkesën për përgjigje ankesë e datës 06.10.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 06.10.2025; Përgjigjen në kërkesë e datës 09.09.2025 nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore i Komunës së Prishtinës; Dëshminë e pranimit të përgjigjes në kërkesë të datës 09.09.2025 nga ankuesja; Vendimin A.nr.943/2025 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë përmbushur kushtet për përfundim të procedimit administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.1665/2025, **sepse:**

Nga administrimi i provave të çështjes rrjedhë së ankuesja është e punësuar në Komunën e Prishtinës, dhe së e njëjta sipas Akt Emërimit 01 nr.112-314, të datës 01.02.2017, është e punësuar në pozitën *Zyrtare për Shërbim me Qytetarë*, në kuadër të Drejtorisë së Administratës, ndërsa, organi i punësimit sipas nenit 102 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyratë Publike, me datë 16.11.2024, ankueses i ka lëshuar Aktin e Emërimit me Nr.01-112-314, ashtu që, pozitën e ankueses *Zyrtare për Shërbim me Qytetarë*. e ka klasifikuar në Kategorinë Profesionale 2, me koeficient të pagës GJ33, 5.1.

Ankuesja, me datë 20.03.2025 përmes parashtresës Nr.14-117/01-40258/25, i është drejtuar më kërkesë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, për kompensim material sipas koeficientit të pagës 5.1-GJ33, duke iu referuara Aktit të Emërimit të lëshuar datë 16.11.2024, e si pas të cilit është dashur të paguhet nga muaji dhjetor 2024. Ndërsa, sipas shkresave thënieve në ankesë dhe përgjigjes në ankesë, organi i punësimit nuk kishte dhënë përgjigje në kërkesën e ankueses të datës 20.03.2025.

Kundër heshtjes administrative të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se e njëjta është duke u dëmtuar financiarisht. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më Vendimin me numër A.nr.943/2025, të datës 07.03.2025, ka aprovuar ankesën e ankueses duke e detyruar Njësinë e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës të shqyrtoj kërkesën e ankueses të parashtruar me datë 20.03.2025 pranë organit punëdhënës.

Ankuesja përmes postës më datë 01.09.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të organit të punësimit/Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, në kërkesën e saj të datës 20.03.2025 edhe përkundër Vendimit A.nr.943/2025 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kërkuar që Këshilli të kërkojë nga njësia e Burimet Njerëzore arsyet mbi heshtjen administrative, të vendos mbi kërkesën në bazë të lëndës së rastit të zhvillojë shqyrtime administrative shtesë, të urdhëroj organin kompetent që të zhvillojë shqyrtime administrative të tilla dhe të njoftohet për rezultatet e shqyrtimit.

Komuna e Prishtinës gjatë procedurës gjegjësisht më datë 10.09.2025, ka ofruar sqarim për Këshillin se më datë 09.09.2025 është shqyrtuar kërkesa e palës ankueses duke dhënë edhe sqarimin citojmë: kemi adresuar në Thesar akt emërimit për ekzekutim të pagave sipas akt emërimeve mirëpo nga Thesari është udhëzuar që paraprakisht të përgatitet Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës e cila është parakusht për procedimin e akt emërimeve dhe pagesave, kështu që, Komuna e Prishtinës është në fazën finale të hartimit të Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe pas miratimit të rregullores do të krijohen kushte për procedim të mëtejshëm të pagave sipas akt emërimeve”.

Kolegji i Këshillit nisur nga gjendja e fakteve si me sipër, vlerëson se lidhur me pretendimin për heshtje administrative, organi i punësimit më datë 09.09.2025 ka dhënë përgjigje në kërkesën e datës 20.03.2025 të ankueses e të cilën përgjigje ankuesja e ka pranuar më datë 10.09.2025, përmes librit të dorëzimit, atëherë, me ndërmarrjen e këtij veprimi, objekti i ankesës është arritur-realizuar dhe është konsumuara heshtja administrative e organit të punësimit lidhur me këtë kërkesë, dhe rrjedhimisht nëse ankuesja ka qenë e pakënaqur me përgjigjen e datës 09.09.2025, e njëjta është dashur të parashtroj ankese të re apo të plotësoj ankesën e datës 05.09.2025. Andaj, mbi bazën e këtyre rrethanave rrjedhë së objekti i ankesës A.nr.1665//2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: “Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot”.

Thënë si më sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
A.nr.1665/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses M.B;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës,
- Arkivit të KPMSHCK-së.